

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Elementet e njohurive të Auditimit të Brendshëm

B1

ID Nr.

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI  
Exam Paper

Udhëzime/Instructions:

1. MOS E HAPNI DERISA T'JU LEJOHET PREJ MBIKËQYRËSIT  
Do Not Open Until Your invigilator Allows You to Do So.
2. ËSHTË E DETYRUESHME PËRGJIGJA E GJITHA PYETJEVE  
All Questions Are Mandatory
3. KOHA E LEJUAR ËSHTË 3 ORË  
Time Allowed is 3 Hours
4. EMRI JUAJ NUK DUHET TË PARAQITET NË ASNJË FLETË TË KËTIJ PROVIMI.  
Your name should appear nowhere in this test.

Data 31.01.2026

CONTENT/ PËRMBAJTJA

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

**Rrumbullakosni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

<b>Pjesa</b>	<b>Maksimumi i dhënë</b>	<b>Kujdes!</b> Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga ShKÇAK <b>PIKËT E DHËNA</b>
1. Pyetje (50 x 2 pikë)	100	
<b>Gjithsej</b>	<b>100</b>	

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

**Rrumbullakosni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

1. Sa i përket etikës në biznes, cila nga më poshtë përfaqëson sjelljen ligjore që pritet nga punonjësit e një organizate?  
**a) Kufiri minimal (minimumi ligjor).**  
b) Kufiri maksimal (maksimumi).  
c) Së pari kufiri minimal, së fundi kufiri maksimal.  
d) Së pari kufiri maksimal, së fundi kufiri minimal.
2. Cila nga më poshtë NUK e përshkruan plotësisht etikën në biznes?  
**a) Marrja e vendimeve me kriter të vetëm fitimin.**  
b) Të dish dallimin mes së drejtës dhe së gabuarës.  
c) Të pajtohesh me normat ose standardet mbizotëruese të shoqërisë.  
d) Marrja e vendimeve në përputhje me atë që duhet të bëhet.
3. Bordi i drejtorëve i korporatave mund të ofrojë cilën nga sa vijon për të shmangur hezitimin e ekzekutivëve për të shqyrtuar opsionet e blerjes (acquisition-buyout)?  
a) Posta e bardhë.  
**b) Parashuta e artë.**  
c) Posta e gjelbërt.  
d) Kalsorësi i bardhë.
4. Menaxhmenti dhe punonjësit e një kompanie të madhe për transportimin e mallrave shtëpiake vendosën të miratojnë menaxhimin total të cilësisë (TQM) dhe përmirësimin e vazhdueshëm (CI). Ata besuan se nëse kompania e tyre do të bëhej e njohur në vend si aderuese e TQM-së dhe CI-së, do të rezultonte në rritje të fitimeve të kompanisë dhe zgjerim të pjesëmarrjes në tregu. Arsyeja kryesore për miratimin e TQM ishte të arrihej:  
**a) Kënaqshmëri më e madhe e klientit.**  
b) Reduktimi i kohës së dorëzimit  
c) Të ulen tarifat e dërgimit.  
d) Pjesëmarrje më e madhe e punonjësve.
5. Cila nga opsionet e më poshtme ka më pak lidhshmëri me cilësinë e produktit ose shërbimit?  
a) ISO 9000.  
b) Përmirësimi i vazhdueshëm.  
**c) Sasia e rendit ekonomik.**  
d) Rrathët e Cilësisë.
6. Pas një vendimi për të ndryshuar përbërjen e ekipeve të prodhimit, menaxhmenti has rezistencë të konsiderueshme ndaj ndryshimit nga anëtarët e departamentit. Arsyeja më e mundshme e rezistencës është:  
a) Jo efikasiteti i strukturës së re.  
**b) Shqetësimet në lidhje me ndryshimet në marrëdhëniet e punës.**  
c) Nën staf për detyrat e përfshira.  
d) Përzgjedhja e një qasje më të kushtueshme për kryerjen e punës së prodhimit.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

**Rrumbullakosni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

7. Një kompani e televizionit kabllor merr depozita nga klientët, të cilat kthehen mbrapsht (rimbursohen) kur shërbimi ndërpritet. Klienti mesatar qëndron me kompaninë tetë vjet. Si duhet të paraqiten këto depozita në pasqyrat financiare?
- Të ardhura operationale.
  - Të ardhura të tjera.
  - Kapital i paguar.
  - Detyrim.**
8. Një dobësi e kontrollit thuhet se ekziston kur komiteti i auditimit i bordit përbëhet nga cila nga sa më poshtë?
- CEO i tanishëm i kompanisë
  - Një CEO në pension i së njëjtës kompani.
  - CFO aktual i së njëjtës kompani.
  - Një aksionar kryesor i së njëjtës kompani.
- I dhe III
  - I, II dhe III
  - I, III dhe IV**
  - I, II, III dhe IV
9. Menaxherët e biznesit mund të përdorin cilin nga sa më poshtë për të kuptuar ndërveprimet midis ligjit, etikës dhe ekonomisë?
- Diagramin Venn**
  - Diagramin Pareto
  - Diagramin e afinitetit.
  - Diagramin e shkakut dhe efektit.
10. Fusha e menaxhimit të rrezikut në ndërmarrje (ERM) përfshin cilat nga sa vijon?
- Krijimin e mundësive.
  - Uljen e rrezikut të mundësive.
  - Analizimin e pikave të forta.
  - Fokusimin në dobësitë.
- I dhe II.**
  - I dhe III.
  - III dhe IV.
  - I, III dhe IV.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

**Rrumbullakosni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

11. Etika, qoftë biznesi apo personale, NUK bazohet në cilën nga sa më poshtë?
  - a) Individët.
  - b) Grupet**
  - c) Situatat.
  - d) Kulturat
  
12. Cili nga hapat e mëposhtëm në ciklin kontabël përfundohet më vonë se të tjerët?
  - a) Rregullimet.**
  - b) Ditari / Regjistrimi në ditar.
  - c) Postimi / Kalimi në librin e madh.
  - d) Identifikimi dhe matja e transaksioneve.
  
13. Lidhur me sigurinë e sistemit të informacionit, qëllimi i analizës së rrezikut është të arrijë një:
  - a) Bilanc teknik midis ndikimit të rreziqeve dhe kostos së masave mbrojtëse.
  - b) Bilanc operacional midis ndikimit të rreziqeve dhe kostos së masave mbrojtëse.
  - c) Bilanc ekonomik midis ndikimit të rreziqeve dhe kostos së masave mbrojtëse.**
  - d) Bilanc ligjor midis ndikimit të rreziqeve dhe kostos së masave mbrojtëse.
  
14. Nga këndvështrimi i menaxhimit të rrezikut të ndërmarrjes (ERM), fusha e menaxhimit tradicional të rrezikut përfshin:
  - a) Sigurimin**
  - b) Rritjen e fitimeve.
  - c) Rritjen e te ardhurave.
  - d) Qeverisjen e korporatave.
  
15. Cili nga hapat e mëposhtëm në procesin e menaxhimit të rrezikut ka shumë të ngjarë të neglizhohet?
  - a) Vlerësimi i rreziqeve.
  - b) Përcaktimi i objektivave.**
  - c) Identifikimi i rreziqeve.
  - d) Përzgjedhja e trajtimeve të rrezikut.
  
16. Cila nga opsionet e më poshtë paraqet hapat në procesin e menaxhimit të rrezikut me katër hapa?
  - a) Zgjidhja e teknikave të menaxhimit të rrezikut dhe blerja e sigurimit për rreziqet e zgjedhura.
  - b) Zgjidhja e teknikave të menaxhimit të rrezikut dhe identifikimi i rreziqeve.**
  - c) Zgjidhja e teknikave të menaxhimit të rrezikut, blerja e sigurimit për rreziqet e zgjedhura dhe identifikimi i rreziqeve.
  - d) Identifikimi i rreziqeve dhe analizimi i ashpërsisë së humbjeve të pritshme.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

**Rrumbullakosni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

17. Hapi i parë në zgjedhjen e teknikave të disponueshme të menaxhimit të rrezikut është:
- Implementoni masa të duhura të kontrollit të humbjeve.
  - Zgjidhni përzierjen optimale të mbajtjes së rrezikut dhe transferimit të rrezikut.
  - Shmangni rreziqet nëse është e mundur.**
  - Përcaktoni disponueshmërinë e mjeteve të menaxhimit të rrezikut.
18. Lidhur me metodat sasiore në menaxhimin e rrezikut, cila nga opsionet e mëposhtme përshkruan saktë faktorin e ekspozimit?
- Kjo metrikë e rrezikut siguron një matje në përqindje të humbjes së mundshme deri në 100% të vlerës së asetit/pasurisë.**
  - Kjo metrikë rreziku merret me shansin ose gjasat e humbjes së pritshme monetare që i atribuohet një ngjarje kërcënimi.
  - Kjo metrikë e rrezikut është thelbësore në analizën e kostos dhe përfitimit të zbutjes së rrezikut dhe në sigurimin e proporcionalitetit në burimet e alokuara për mbrojtjen e pasurive.
  - Kjo metrikë e rrezikut paraqet koston e pritur monetare të një ngjarje kërcënimi.
19. Një tabelë organizative tipike që shfaq piramidën menaxheriale do të ketë dy dimensione: horizontale dhe vertikale. Këto dimensione përfaqësojnë:
- Organizatata zyrtare dhe joformale.
  - Përgjegjësinë dhe autoritetin.
  - Ndarjen e punës dhe zinxhirin e udhëheqjes.**
  - Kanalet raportuese dhe hierarkia e autoritetit.
20. Ndërsa një organizatë rrit numrin e të punësuarve, struktura e saj bëhet më komplekse. Rregullat bëhen më të zyrtarizuara, dhe më shumë mbikëqyrës punësohen për të drejtuar numrin e rritur të vartësve. Cila është natyra e marrëdhënies madhësi - strukturë?
- Marrëdhënia madhësi - strukturë është lineare.
  - Struktura bëhet fikse sapo një organizatë të arrijë një nivel prej rreth 200 punonjësish.
  - Marrëdhënia madhësi - strukturë është konkave.
  - Asnjë nga të mësipërmet.**
21. Ndryshimi dhe pasiguria në mjedis të punës zakonisht shoqërohen me cilën nga të mëposhtmet?
- Specializimin e punës.
  - Decentralizimin.**
  - Centralizimin.
  - Kontrollin vertikal të rreptë.
22. Në organizatat e menaxhuara mirë, marrëdhënia midis strukturës dhe strategjisë është se:
- Struktura ndjek strategjinë.**
  - Struktura ndikon në teknologjinë.
  - Struktura dikton strategjinë.
  - Struktura i përshtatet strategjisë së punës.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

**Rrumbullakosni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

23. Një dyqan me pakicë shet USB për 16,00 €. Nëse kosto për USB është 12,00 €, sa është marzha e fitimit në çmimin e shitjes?

- a) 22%
- b) 66%
- c) 33%**
- d) 27%

$$\text{Marzha e fitimit} = (\text{Çmimi} - \text{Kosto}) / \text{Çmimi} = (16 - 12) / 12 = 4/12 = 0,333 = 33\%.$$

24. Synimi i konceptit "pikërisht në kohë" përqendrohet përgjithësisht në:

- a) Cilësinë, kostot e inventarit dhe shërbimin ndaj klientit.
- b) Kostot, shërbimin, çmimin dhe cilësinë.
- c) Shërbimin ndaj klientit, kostot e inventarit dhe efikasitetin e prodhimit.
- d) Cilësinë, shërbimin ndaj klientit, kostot e inventarit dhe efikasitetin e prodhimit.**

25. Cila nga më poshtë NUK është shembull i mbajtjes së rrezikut (risk retention)?

- a) Përdorimi i kredisë.**
- b) Përdorimi i fondeve rezervë.
- c) Inkorporimi (themeli/inkorporimi i biznesit).
- d) Vetë-sigurimi.

26. Cili është faktori më i rëndësishëm për t'u marrë parasysh kur vendoset për tu furnizuar nga një burimi i vetëm ose burime të shumëfishta për një komponent kritik?

- a) Kapaciteti i disponueshmërisë së furnitorit.
- b) Dëshira për të ruajtur konkurrencën për biznesin.
- c) Kostoja e veglave dhe konfigurimit.
- d) Numri i furnitorëve në treg.**

27. Një kompani ka kapacitet të tepërt në pasuri fikse të lidhura me prodhimin. Nëse në një vit të caktuar këto pasuri fikse po përdoren vetëm për 50% të kapacitetit dhe niveli i shitjeve në atë vit ishte €1,000,000, niveli i plotë i kapacitetit të shitjeve është:

- a) 1,600,000 €
- b) 2,000,000 €**
- c) 2,500,000 €
- d) 10,000,000 €

$$\text{Shitjet aktuale} / \text{Përqindja e kapacitetit me të cilin operohen pasurit fikse} = €1,000,000 / 0,50 = €2,000,000$$

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

**Mrumbullakosni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

28. Cila nga opsionet e mëposhtme NUK konsiderohet kosto e mbajtjes së inventarit?
- a) **Transporti dhe manovrimi**
  - b) Tatimi i pronës
  - c) Sigurimi.
  - d) Amortizimi dhe vjetërsimi.
29. Shumica e menaxherëve kanë cilin qëndrim të mëposhtëm ndaj thashethemeve?
- a) Pozitiv
  - b) E pasigurt
  - c) **Negativ**
  - d) Neutrale
30. Cili nga opsionet e mëposhtme është mediumi më i pasur për komunikim?
- a) Biseda telefonike.
  - b) **Diskutim ballë për ballë.**
  - c) Media elektronike.
  - d) Media e shkruar.
31. Cila nga të mëposhtmet është sekuenca e saktë e qëllimeve organizative nga pikëpamja nga poshtë-lart?
- a) Qëllimet operacionale, strategjike, taktike.
  - b) Qëllimet taktike, operacionale, strategjike.
  - c) Qëllimet strategjike, taktike, operacionale.
  - d) **Qëllimet operacionale, taktike, strategjike.**
32. Cila nga strategjitë e mëposhtme mund të jetë fitimprurëse për një organizatë kur klientët janë besnikë dhe të gatshëm të paguajnë çmime të larta për produktet ose shërbimet e saj?
- a) Fokusimi
  - b) Rritja e brendshme
  - c) Udhëheqja e kostos
  - d) **Diferencimi**
33. Formulimi i strategjisë përfshin cilën nga të mëposhtmet?
- a) Formulimi i strategjisë në nivel të korporatave, nivel të biznesit dhe nivel të divizioneve.
  - b) Formulimi i strategjisë në nivel funksional, në nivel të punonjësve dhe në nivel të klientit.
  - c) **Formulimi i strategjisë në nivelit të korporatës, nivel të biznesit dhe nivel funksional.**
  - d) Formulimi i strategjisë në nivelin bazë, nivel të zyrës dhe nivel të magazinës.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

**Crumbullakosni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

34. Në kontekstin e menaxhimit total të cilësisë, mënyra më e mirë për të identifikuar dhe eliminuar hapat e panevojshëm të punës në një proces kryhet përmes:
- a) Diagramit të rrjedhjes**
  - b) Diagramit tabelor
  - c) Diagramit me vija.
  - d) Tabela Pareto.
35. Në metodologjinë e Sigma gjashtë (six sigma), në cilën nga fazat e mëposhtme përdoret mjeti i korigjimit të gabimit?
- a) Përcaktimin
  - b) Kontrollin**
  - c) Masën
  - d) Përmirësimin
36. Në cilën nga strukturat e mëposhtme organizative menaxhimi total i cilësisë funksionon më mirë (TQM)?
- a) Struktura organizative hierarkike.
  - b) Ekipet e njerëzve nga i njëjti specializim.
  - c) Ekipet e njerëzve me specializime të ndryshme.**
  - d) Specialistët që punojnë individualisht.
37. Cila nga të mëposhtmet **nuk** ka nevojë të bëhet backup?
- a) Çelësi privat për transport.
  - b) Çelësi publik për transport .
  - c) Autentikimi publik .
  - d) Çelësi privat i nënshkrimit.**
38. Modeli COBIT (Objektivat e kontrollit për teknologjinë informative dhe të ngjashme) i të Institutit të qeverisjes së teknologjisë informative (ITGI) përqendrohet në:
- a) Planifikimin e TI.
  - b) Qeverisjen e TI**
  - c) Standardet e TI
  - d) Infrastrukturën e TI.
39. Një aplikacion i shitjes përmes internet prishet ndërsa transaksionet janë në proces. Kontrolli më i mirë për të siguruar që çdo transaksion në proces të ketë përfunduar me sukses kur sistemi rifillon funksionimin është:
- a) Rindërtimi manual i transaksioneve në proces nga shitësit.
  - b) Restartimi automatike që i shtyn shitësit të përfundojnë transaksionet në proces.**
  - c) Barazimi kompjuterik i totalit të artikullit të pranuar.
  - d) Barazimi manual i totalit të artikullit të pranuar.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

**Mrumbullakosni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

40. Një pasuri afatgjatë i sapo blerë duhet të zhvlerësohet gjatë jetës së tij të dobishme. Baza logjike për këtë proces është:

- a) Supozimi i njësisë ekonomike.
- b) Supozimi i njësisë monetare.
- c) Supozimi i materialitetit.
- d) Supozimi i vijimësisë.**

41. Informacioni i mëposhtëm është pjesë e një bilanci të pa rregulluar të një kompani që jap pajisje me qira më 31 dhjetor 2019:

Paraja në gatshme	€ 17,400
Sigurimi i parapaguar	€ 3,600
Pasuritë jo-qarkulluese	€ 180,000
Zhvlerësimi i akumuluar	€ 32,000
Të pagueshmet tregtare	€ 12,000
Aksionet e zakonshme	€ 60,000
Fitimet e mbajtura	€ 38,000
Gjithsej të hyrat	€ 171,000
Shpenzimet e pagave	€ 80,000
Shpenzimet administrative	€ 14,000

Më 1 tetor 2019, kompania pagoi €18,000 për të rinovuar politikën e vetme të sigurimit për një periudhë tre vjeçare që fillon në atë datë. Ky transaksion nuk është regjistruar. Pagat prej €1,700 janë kryer por nuk janë paguar më 31 Dhjetor 2019. Në 31 Dhjetor 2019, gjendja në deklaratën bankare ishte €12,000. Çeçet e pa paguara arritën në €6,900. Interesi prej €40 ishte kredituar në llogarinë e kompanisë nga banka gjatë dhjetorit, por ende nuk është regjistruar në librat e kompanisë.

Cilat shuma duhet të raportojë kompania për sigurimin e parapaguar dhe shpenzimet e sigurimit në pasqyrat vjetore financiare të përgatitura më 31 Dhjetor 2019?

- a) Sigurimi i parapaguar € 16,500 - Shpenzimet e sigurimit € 1,500
- b) Sigurimi i parapaguar € 16,500 - Shpenzimet e sigurimit € 5,100**
- c) Sigurimi i parapaguar € 18,000 - Shpenzimet e sigurimit € 3,600
- d) Sigurimi i parapaguar € 20,100 - Shpenzimet e sigurimit € 1,500

Llogaritje:

€ 18,000 / 36 muaj = € 500 në muaj

36 muaj - 3 muaj (tetor, nëntor dhe dhjetor 2012) = 33 muaj

€ 500 × 33 muaj = € 16,500 sigurimi i parapaguar në 31 Dhjetor 2019

Salldo fillestare e parapagimit € 3,600

+ Pagesat më 1.10.2019 €18,000

= Gjithsej € 21,600

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

**Rrumbullakosni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

- Salldo e sigurimit të parapaguar € 16,500  
= Shpenzimi i sigurimit € 5,100

42. Më 1 dhjetor 2019, një kompani shiti shërbime tek një klient dhe pranoi një letër me vlerë në këmbim me një vlerë nominale €120,000 dhe një normë interesi prej 10%. Letër me vlerë kërkon që principali dhe interesi të paguhet në datën e maturimit, 1 Dhjetor 2020. Periudha kontabël e kompanisë është viti kalendarik. Çfarë hyrje rregulluese (lidhur me këtë shënim) do të kërkohej më 31 Dhjetor 2019, në librat e ndërmarrjes?
- a) Të ardhurat e shtyra nga interesi €1,000 – Të arkëtueshmet €1,000
  - b) Të ardhurat nga interesi €1,000 – Të arkëtueshmet €1,000
  - c) Të arkëtueshmet €1,000 - Të hyrat e shtyra €1,000
  - d) Të arkëtueshmet €1,000 – Të ardhurat nga interesi €1,000**
43. Më 31 dhjetor, një kompani ka asete totale me vlerë kontabël prej 300,000 €. Detyrimet janë 120,000 €. Gjithashtu, më 31 dhjetor, aksionet shiten me 20 € për aksion dhe janë 10,000 aksione në qarkullim. Si rezultat, kompania duhet të marrë diferencën midis vlerës kontabël dhe vlerës së drejtë të tregut të aksioneve dhe:
- a) T'a kapitalizojë si pasuri (dhe t'a zhverlësojë gjatë jetës së vlerësuar të dobishme jo më shumë se 40 vjet), duke e kompensuar tek ekuiteti i aksionerëve.
  - b) T'a kapitalizojë si pasuri (dhe t'a zhverlësojë gjatë jetës së vlerësuar të dobishme), duke e kompensuar tek të ardhurat.
  - c) T'a kapitalizojë si pasuri (dhe t'a zhverlësojë gjatë pesë viteve), duke e kompensuar tek ekuiteti i aksionerëve.
  - d) Të mos kapitalizojë asnjë pasuri, të mos regjistrojë asnjë të ardhur dhe as të mos ndryshojë ekuitetin e aksionerëve në këtë moment.**
44. Qëllimi i një regjistrimi, i cili përmban një debit për parapagimin e tatimit në prone dhe një kredi për shpenzimet e tatimit në pronë, është të njohë një:
- a) Shpenzim të parapaguar**
  - b) Shpenzim të përllogaritur
  - c) Të ardhura të parapaguar
  - d) Kosto të skaduar
45. Amortizimi i pasurive të pa prekshme gjatë jetës së tyre të dobishme justifikohet nga:
- a) Supozimi i subjektivit ekonomik.
  - b) Supozimi i vijimësisë**
  - c) Supozimi i njësisë monetare.
  - d) Supozimi i kostos historike.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

**Rrumbullakosni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

46. Çfarë përfundimi duhet të nxjerrë një analist financiar nëse një kompani ka një raport të lartë të qarkullimit të aseteve fikse?
- a) Kompania mund të jetë duke kapitalizuar tej mase.
  - b) Kompania mund të ketë një problem me punëtorët që konvertojnë inventarin në përdorim personal.
  - c) Kompania mund të jetë e nën-kapitalizuar**
  - d) Kompania ka përfitim të favorshëm.
47. Menaxhmenti i Korporatës TapIntuit po analizon pasqyrat financiare të Korporatës Cosmo sepse TapIntuit po konsideron blerjen e disa aksioneve të zakonshme të Cosmo që do t'i jepte TapIntuit ndikim të rëndësishëm mbi Cosmo. Cilën pasqyrë financiare duhet të përdorë kryesisht TapIntuit për të vlerësuar shumat, kohën dhe pasigurinë e flukseve të parave të ardhshme të kompanisë Cosmo?
- a) Pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse
  - b) Pasqyrën e fitimeve të mbajtura.
  - c) Pasqyrën e rrjedhjes së parasë së gatshme**
  - d) Pasqyrën e Pozitës Financiare
48. Standardi i materialeve për njësi të mallrave të përfunduar është 3kg e lëndës së parë me 5,00 EUR/kg. Gjatë korrikut kompania bleu 3,700kg të lëndës së parë me një kosto totale prej 18,130 EUR dhe vendosi 3,600kg në prodhim duke prodhuar 1,220 njësi të mallrave të gatshëm.
- Varianca e përdorimit të materialeve të drejtpërdrejtë për muajin korrik ishte:
- a) €300 të favorshëm.**
  - b) €294 të favorshëm.
  - c) €200 të pafavorshëm.
  - d) €300 të pafavorshëm.
- Përlllogaritja:  $1,220 \times 3\text{kg} = 3,660$  ;  $(3,600 - 3,660) \times 5 = 300$
49. Fitimi marginal është i barabartë me:
- a) Ndryshimi në fitimin total pas një ndryshimi prej një njësie në prodhim.**
  - b) Ndryshimi në fitimin total pas një vendimi menaxherial.
  - c) Të ardhurat mesatare minus kosto mesatare.
  - d) Të ardhurat totale minus kosto totale.
50. Akti Clayton ndalon në mënyrë specifike cilën nga të mëposhtmet?
- a) Monopolet
  - b) Blerjet e aseteve që ulin konkurrencën
  - c) Marrëveshjet ekskluzive**
  - d) Komplotet në kufizimin e tregtisë